



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

VENDIM

Nr. 53 , datë 24.07.2019

PËR NDALIMIN E KANDIDIMIT TË Z. ALTIN HAZIZAJ NË VENDIN VAKANT
PËR INSPEKTOR I LARTË I DREJTËSISË, SHPALLUR NGA KËSHILLI I
EMËRIMEVE NË DREJTËSI NË DATËN 01.03.2019

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, i përbërë nga:

Ardian Dvorani	- Kryetar
Vitore Tusha	- Zëvendëskryetare
Arta Marku	- Anëtare
Margarita Buhali	- Anëtare/Relatore
Fatjona Memçaj	- Anëtare
Fatri Islamaj	- Anëtar
Eriol Roshi	- Anëtar

Asistuar nga sekretare **Dorina Dulaj**,

Me praninë e përfaqësuesit të Avokatit të Popullit, **zotit Enio Haxhimihali**, në cilësinë e vëzhguesit të përhershëm të mbledhjeve dhe veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi,

Me praninë e përfaqësuesve të autorizuar të subjekteve të ftuara sipas ligjit për pjesëmarrje, në cilësinë e vëzhguesve, në mbledhjen e Këshillit:

- **zotit Bledar Dervishaj**, përfaqësuesi i autorizuar i Presidentit të Republikës,

në mbledhjen e datës 17.07.2019 dhe 24.07.2019, mori në shqyrtim çështjen që i përket:

**KANDIDAT PËR INSPEKTOR
I LARTË I DREJTËSISË**

Z. Altin Hazizaj

OBJEKTI:

Urdhërimi i ndalimit të kandidimit të z. Altin Hazizaj, në vendin vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, të shpallur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në datën 01.03.2019.

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

Pasi dëgjoi relatimin e anëtares së Këshillit, **znj. Margarita Buhali**, mendimin e paraqitur nga përfaqësuesi i Avokatit të Popullit, z. Enio Haxhimihali, në cilësinë e vëzhguesit të përhershëm në mbledhjen dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatit, dhe si bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Në zbatim të nenit 147/d të Kushtetutës dhe të nenit 199 dhe 229 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në datën 01.03.2019, ka shpallur hapjen e procedurës së aplikimeve për vendin vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë.
2. Në përfundim të procedurës së aplikimeve për shprehjen e interesit për kandidim, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka filluar shqyrtimin e aplikimeve të kandidatëve të shoqëruara me dokumentet e paraqitura prej tyre për përmbushjen e kushteve dhe kriterëve ligjore të përcaktuara në nenin 199 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.
3. Ndërmjet kandidatëve që kanë shprehur interesin për plotësimin e këtij vendi vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, është edhe z. Altin Hazizaj.
4. Në zbatim të nenit 147/d dhe 149/d të Kushtetutës dhe të nenit 199 dhe 229 dhe 235 e vijues të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si edhe të pikës 98 të aktit nënligjor normativ, Vendimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në mbledhjen e zhvilluar në datën 05.04.2019, vendosi fillimin e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes të kandidatëve që kanë shprehur interesin për vendin vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë.
5. Në zbatim të nenit 228 të Ligjit nr. 115/2016 dhe të pikave 5, 27 deri 37 dhe 41 të aktit nënligjor normativ, Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 2 datë 15.02.2019 “Për procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion”, si edhe të pikës 4 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, në të njëjtën ditë të mbledhjes së zhvilluar në datën 05.04.2019, është realizuar edhe procedura për caktimin me short manual të relatorëve për secilin nga vendet vakante të krijuara në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë i Drejtësisë.
6. Sipas rezultatit të shortit manual të realizuar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, lidhur me zgjedhjen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të shpallur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në datën 01.03.2019, relatore për ndjekjen e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturave, është caktuar anëtarja e Këshillit, znj. Margarita Buhali.
7. Z. Altin Hazizaj, si njëri ndër kandidatët që ka shprehur interesin për vendin vakant të sipërcituar për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, në zbatim të pikës 22 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, është njoftuar me shkrim për tu paraqitur pranë Këshillit për të vijuar me përmbushjen e procedurave të verifikimit të kandidaturës. Njoftimi me shkrim, i kryer në rrugë elektronike në adresën e deklaruar nga vetë kandidati Altin Hazizaj, gjendet i administruar në dosjen e kandidatit.

8. Në datën 10.04.2019, kandidati Altin Hazizaj është paraqitur pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe është pajisur me formularët e deklaramit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij. Kryerja e kësaj procedure vërtetohet nga nënshkrimi prej vetë kandidatit të Deklaratës përkatëse, e cila gjendet e administruar në dosjen e kandidatit.

9. Në datën 15.04.2019, kandidati Altin Hazizaj ka depozituar në sekretarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi formularë të deklaramit dhe autorizimet përkatëse për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij, të cilat gjenden të administruara në dosjen e kandidimit.

10. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e pasurisë, në zbatim të nenit 235 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 60 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 "*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*", me shkresën nr. 265 prot, datë 19.04.2019, Këshilli i ka dërguar ILDKPKI-së listën e kandidatëve dhe personave të lidhur me ta që i nënshtrohen procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit sipas Ligjit nr. 8577/2000 dhe Ligjit nr. 115/2016.

11. Bashkëlidhur kësaj shkrese drejtuar ILDKPKI-së, ndërmjet të tjerave, është vendosur edhe Deklarata e nënshkruar nga kandidati Altin Hazizaj, ku tregohet se është pajisur me formularët e deklaramit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij, si edhe data e nënshkrimit, nga e cila fillojnë të llogariten afatet e përcaktuara nga ligji për përmbushjen e detyrimeve ligjore të kandidatit për procedurën e verifikimit të kandidaturës.

12. Me shkresën nr. 2854/3 prot, datë 26.04.2019, ILDKPKI ka informuar Këshillin e Emërimeve në Drejtësi se kandidati Altin Hazizaj e ka përmbushur detyrimin e përcaktuar nga pika 2 e nenit 235 të Ligjit nr. 115/2016 për të dorëzuar të plotësuar pranë atij institucioni Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Privatë të Kandidatit për Pozicione të Ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë.

13. ILDKPKI, në zbatim të nenit 235 të ligjit nr. 115/2015, të ligjit nr. 9049/2003 dhe ligjit nr. 9367/2005, me shkresën nr. 3/28 prot., datë 29.05.2019, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatin Altin Hazizaj dhe personat e lidhur me të.

14. Gjithashtu, në funksion të ushtrimit të kompetencave të tij për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, për sa i përket kontrollit të pasurisë, në zbatim të pikës 4 të nenit 229 dhe 235 të ligjit nr. 115/2016, të shkronjës "e" të pikës 20, 24, shkronjës "b" të pikës 60 e vijues të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 "*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*", edhe ky Këshill ka kryer veprimet verifikuese të kërkimit nga subjekte publike dhe private, të të dhënave mbi pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare që ekzistojnë në emër dhe për llogari të kandidatit Altin Hazizaj dhe personave të lidhur me të.

15. Për realizimin e veprimeve verifikuese të lidhura me kontrollin e pasurisë së kandidatit Altin Hazizaj, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në datën 17.04.2019, i është drejtuar me kërkesa për institucioneve publike dhe subjekteve private (të cilat janë administruar në dosjen e kandidimit), si më poshtë:

- a) Institucioneve bankare: (1) Banka Alpha Albania, (2) Banka Amerikane e Investimeve, (3) Banka Credins, (4) Banka e Bashkuar e Shqipërisë, (5) Banka e Kreditit e Shqipërisë, (6) Banka e Parë e Investimeve, (7) Banka Intesa Sanpaolo, (8) Banka Kombëtare Tregtare, (9) Banka Ndërkombëtare Tregtare, (10) Banka Procredit, (11) Banka Raiffeisen, (12) Banka Societe Generale, (13) Banka Tirana dhe (14) Banka Union.
- b) Institucioneve financiare të licencuara nga Banka e Shqipërisë : (1) Ak-Invest, (2) Albania Leasing, (3) Capital Invest, (4) Easypay sh.p.k, (5) Final sha, (6) Fondi Besa, (7) Iutecredit Albania, (8) Landeslease, (9) M – Pay sh.p.k. (10) NOA sha, (11) Porsche Leasing, (12) Posta Shqiptare, (13) Raiffeisen Leasing, (14) Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit – FAF, (15) Tirana Factoring & Lease, (16) Tranzit sha, (17) Union Financiar Tiranë.
- c) Subjekteve financiare të licencuar nga AMF : (1) Fondi i Pensionit Vullnetar Credins Pension, (2) Fondi i Investimit Credins Premium, (3) Fondi i Investimit Raiffeisen Invest Euro, (4) Fondi i Investimit Raiffeisen Prestigj, (5) Fondi i Investimit Raiffeisen Vision, (6) Fondi i Investimit ËVP Top Invest, (7) Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen, (8) Fondi i Pensionit Vullnetar Sigal.
- ç) Institucione të tjera publike si : (1) Agjencia Shtetërore e Kadastrës, (2) DPSHTRR, (3) D.P.Tatimeve, (4) M.Drejtësisë, (5) OSHEE, (6) QKB, (7) UKT.

16. Në përgjigje të kërkesave për informacion të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, të gjitha institucionet publike dhe subjektet private të treguara në pikën 15 më sipër, kanë dërguar pranë Këshillit përgjigjet përkatëse ku përmbahen të gjitha të dhënat e kërkuara mbi pasuritë e kandidatëve, nëse kanë pasur të tilla për secilin prej tyre, përfshirë edhe kandidatin Altin Hazizaj.

17. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, në zbatim të nenit 236 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 82 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, me shkresën nr. 111 prot, datë 17.04.2019, Këshilli ka dërguar në Prokurorinë e Përgjithshme për kompetencë formularin e vetëdeklarimit të plotësuar nga kandidati Altin Hazizaj sipas ligjit nr. 138/2015.

18. Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr. 1123/65 prot., datë 03.05.2019, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatin Altin Hazizaj.

19. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit të kandidatis Altin Hazizaj, në zbatim të nenit 236 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 84 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Këshilli i është drejtuar me kërkesë për informacion Drejtorisë së Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (*shkresa nr. 121 prot, datë 17.04.2019*), Shërbimit Informativ të Shtetit (*shkresa nr. 115 prot, datë 17.04.2019*), Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes (*shkresa nr. 119 prot, datë 17.04.2019*) dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat pranë Ministrisë së Brendshme (*shkresa nr. 116 prot, datë 17.04.2019*).

20. Gjithashtu, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në vijim të procedurës së sipërcituar në pikën 19 për verifikimin e integritetit, me shkresën nr. 352 prot., datë 20.05.2019, i është drejtuar Drejtorisë së Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar me kërkesë për ndihmë

administrative për përpunimin e informacionit të klasifikuar për qëllimet e verifikimit të integritetit të kandidatëve.

21. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar dhe Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat pranë Ministrisë së Brendshme kanë dërguar përgjigjet e tyre, përkatësisht me shkresat *nr. 1545 prot., datë 10.06.2019* dhe *nr. 680/1 prot., datë 15.05.2019*.

22. Gjithashtu, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, në zbatim të nenit 229 dhe 236 të Ligjit nr. 115/2016, të dispozitave të ligjit nr. 45/2015, si edhe në zbatim të pikës 85 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, me shkresën nr. 113 prot, datë 17.04.2019, Këshilli ka dërguar formularin e aplikimit përkatës të plotësuar sipas ligjit nga kandidati Altin Hazizaj për kompetencë dhe shqyrtim Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit.

23. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, me shkresën nr. 550/4 prot., datë 03.05.2019, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatin Altin Hazizaj.

24. Për verifikimin e kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit, në zbatim të nenit 237 dhe 240 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikave 91-93 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, Këshilli ka marrë në shqyrtim dokumentacionin përkatës të depozituar nga vetë kandidati Altin Hazizaj në momentin e kandidimit pranë organit të emërtesës që ka shpallur vendin vakant.

25. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 3 e nenit 147/d të Kushtetutës dhe shkronja “dh” e pikës 1 të nenit 199 të ligjit nr. 115/2016, pra që kandidati *të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit*, Këshilli në datën 02.05.2019 i është drejtuar më kërkesë për informacion partive politike, si dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (*shkresa nr. 270 prot., datë 19.04.2019*), duke i bashkëlidhur listat e të gjithë kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë të Drejtësisë. Në përgjigje të këtyre kërkesave, KQZ dhe parti politike kanë dërguar informacione lidhur me ekzistencën ose jo të të dhënave që do të vërtetonin angazhimin në ndonjë pozicion drejtues në parti politike të secilit prej kandidatëve, përfshirë edhe kandidatin Altin Hazizaj.

26. Këshilli i ka kërkuar kandidatin Altin Hazizaj të paraqesë shpjegime me shkrim dhe dokumente shtesë lidhur me vjetërsinë në punë dhe detyrën e kryer nga ana e tij, përfshirë dokumente të tilla si vërtetim nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë që ka përfutur titullin avokat, vërtetim nga sigurimet shoqërore dhe Drejtoria e Tatimeve që janë paguar detyrimet sipas deklarimeve që ka kryer subjekti, si dhe vërtetim që sipas nenit 199/1 shkronja “d”, ndaj tij nuk ka masë disiplinore.

27. Në datën 24.04.2019, kandidati Altin Hazizaj ka paraqitur me shkrim shpjegime si edhe dokumente shtesë.

28. Gjithashtu, për këtë rast kandidimi, Këshilli vlerësoi ti drejtohet me kërkesa për informacion disa institucioneve publike dhe subjekte private, pranë të cilave kandidati Altin Hazizaj ka ushtruar funksione publike ose veprimtari private profesionale apo ku gjenden të dhëna lidhur me ushtrimin e detyrave dhe veprimtarinë profesionale të kandidatis si Instituti i

Sigurimeve Shoqërore (shkresa nr. 276 prot, datë 19.04.2019), Dhoma Kombëtare e Avokatisë (shkresa nr. 323 prot, datë 07.05.2019) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (shkresa nr. 275 prot, datë 19.04.2019).

29. Lidhur me të dhënat e kërkuara, Këshilli ka marrë përgjigje me shkrim nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore (shkresa nr. 4090 prot, datë 09.05.2019 dhe nr. 3079/2 prot, datë 24.04.2019), Dhoma Kombëtare e Avokatisë së Shqipërisë (shkresa nr. 211 prot, datë 07.05.2019) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (shkresa nr. 8345/1 prot, datë 15.05.2019).

30. Në përfundim të veprimeve dhe procedurave të kontrollit dhe verifikimit, në zbatim të neneve 235, 236 dhe 237 të ligjit nr. 115/2016, si edhe të pikave 29, 75 dhe 87 të Vendimit nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, duke vlerësuar paraprakisht se ka të dhëna dhe gjetje që mund të sjellin ndalimin e kandidimit, anëtarja relatore e Këshillit, znj. Margarita Buhali, ka proceduar me përgatitjen e relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm dhe e ka dërguar çështjen për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit.

31. Në zbatim të pikës 33 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Kryetari ka thirrur mbledhjen e Këshillit duke njoftuar anëtarët për zhvillimin e saj në datën 17.07.2019, rendin e ditës, si edhe duke i bashkëlidhur njoftimit materialet e çështjes. Në rendin e ditës është përfshirë edhe çështja me objekt shqyrtimin e gjetjeve në procedurën e verifikimit të kandidimit të z. Altin Hazizaj, për vendin vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, të shpallur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në datën 01.03.2019.

32. Në zbatim të pikës 34 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes, së bashku me relacionin e përgatitur nga relatori, i është njoftuar kandidatit Altin Hazizaj.

33. I njëjti njoftim, së bashku me dokumentacionin e përgatitur nga relatori mbi veprimet e kryera gjatë procedurës së verifikimit, si edhe materiale të çështjes, i janë dërguar edhe Avokatit të Popullit.

34. Për zhvillimin e mbledhjes së Këshillit në datën 17.07.2019, rendin e ditës dhe relacionin e përgatitur janë njoftuar edhe subjektet që sipas ligjit ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit.

35. Dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes, si edhe rendi i ditës janë njoftuar publikisht edhe në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e caktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

36. Në mbledhjen e Këshillit, pas relatimit të parashtruar nga anëtari relator dhe shpjegimeve mbi pyetjet sqaruese të drejtuara nga anëtarët e Këshillit, Këshilli dëgjoi mendimin e Avokatit të Popullit lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatit Altin Hazizaj.

37. Në thelb, Avokati i Popullit, krahas qëndrimit të përgjithshëm se edhe për këtë rast nuk ka pasur nga KED në dispozicion dokumentacionin e plotë ku bashkëlidhur akteve të procedurës

së verifikimit mungojnë edhe një pjesë dokumenteve dhe përgjigjeve të sjella nga institucionet, parashtrori se:

- kandidati Altin Hazizaj ka mungesë dokumentesh që vërteton ezaurimin e kritereve dhe kushteve ligjore të kandidimit,
- formulari i vetëdeklarimit është i paplotë,
- janë të evidentuara probleme me deklarimin e pasurisë për të cilat i janë kërkuar shpjegime me shkrim kandidatit por në relacion mungon një analizë e KED për gjetjet në procesin e verifikimit të pasurisë
- mungon në relativ informacion për kthim të përgjigjes nga SHISH lidhur me verifikimin e kushtit ligjor të parashikuar nga neni 199 pika 2/e e ligjit nr. 115/2016.

II. Vlerësimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi

38. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, duke u bazuar në dispozitat ligjore dhe ato nënligjore normative të zbatueshme për çështjen në shqyrtim, si edhe në rrethanat e faktit që rezultojnë në aktet që përmban dosja e kandidatit, vlerëson se duhet të procedojë me vendim për ndalimin e kandidimit të kandidatit Altin Hazizaj për vendin vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, të shpallur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në datën 01.03.2019.

39. Në pikën 3 të nenit 147/d të Kushtetutës, parashikohet se:

“3. Inspektori i Lartë i Drejtësisë zgjidhet me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit, për një periudhë 9-vjeçare, pa të drejtë rizgjedhjeje, nga radhët e juristëve të spikatur me jo më pak se 15 vjet përvojë pune në profesion, me integritet të lartë moral dhe profesional. Ai nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit.”

40. Në pikën 1 të nenit 199 të Ligjit nr. 115/2016 parashikohet se:

“1. Inspektor i Lartë i Drejtësisë mund të zgjidhet shtetasi shqiptar, që në momentin e kandidimit përmbush këto kushte:

a) të jetë shtetas shqiptar;

b) të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi me diplomë “Master i shkencave”, ose diplomë të njësuar me të, ose studimet universitare për drejtësi jashtë shtetit dhe të ketë marrë një diplomë të njësuar, sipas rregullave për njësimin e diplomave, të parashikuara me ligj;

c) ka jo më pak se 15 vjet përvojë pune në profesion si jurist;

ç) nuk është dënuar më parë për kryerjen e një veprë penale;

d) nuk është pushuar nga puna më parë për shkaqe disiplinore dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi në momentin e kandidimit;

dh) nuk ka mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit;

e) nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar të ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991 në kuptimin e ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

ë) nuk është bashkëpunëtor, informator ose agjent i shërbimeve të inteligjencës.”

41. Kushtet e kandidimit për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, të parashikuara nga Kushtetuta dhe ligjet e nxjerra në pajtim me të, sikurse janë edhe ato të përmendura në pikat 39 dhe 40 më sipër, duhet të plotësohen secila dhe të gjitha së bashku në mënyrë që kandidati të pranohet për tu vlerësuar dhe renditur sipas meritave nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi dhe më tej për tu Inspektor i Lartë i Drejtësisë nga Kuvendi.

42. Nëse kandidati për Inspektor i Lartë i Drejtësisë nuk plotëson qoftë edhe njërin prej kushteve dhe kriterëve ligjorë të kandidimit, kjo do të përbënte motiv ligjor të mjaftueshëm për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi për të vënë në bisedim dhe për të disponuar ndalimin e kandidimit, pa qenë më e nevojshme të arsyetojë për plotësimin ose jo të kushteve të tjera ligjore.

43. Nisur nga të dhënat dhe gjetjet që rezultojnë nga procedura e verifikimit për kandidatin Altin Hazizaj, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerësoi të bisedojë dhe të konkludojë pikësisht në lidhje me plotësimin ose jo të kushtit ligjor të parashikuar nga neni 235 i ligjit nr. 115/2016, pra që kandidati duhet të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë personale dhe të familjarëve të tij.

44. Për sa i përket procedurës së verifikimit të pasurisë, në përfundim të veprimeve të kontrollit të ushtruar në zbatim të nenit 235 të ligjit nr.115/2015, të ligjit nr. 9049/2003 dhe ligjit nr. 9367/2005, ILDKPKI, me shkresën nr. 3/28 prot., datë 29.05.2019, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatin Altin Hazizaj dhe personat e lidhur me të.

45. Në përfundim të analizës së hollësishme financiare të kryer mbi bazën e gjetjeve të siguruar nga informacionet e dërguara nga institucione publike dhe subjekte private, lidhur me deklarinë e pasurisë dhe interesave private të kandidatit Altin Hazizaj, ILDKPKI në raportin e paraqitur ka ardhur në përfundimet se:

- a) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin,
- b) ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasurinë;
- c) ka mosdeklarim të pasurisë;
- ç) nuk ka kryer deklarim të rremë;
- d) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

46. Përfundimet e sipërcituara të ILDKPKI, bazohen në gjetjet vijuese të raportit të kontrollit:

- Rezulton se apartamenti me sip. 55m² në Rr. "Q.S" Tiranë, është përfituar nga privatizimi në vlerën 4.263 lekë në vitin 1993. Nuk është e qartë se çfarë është patur parasysh me vlerën e deklaruar prej 50.000 euro.
- Rezulton se apartamenti me sip. 92.5 m², në Tiranë i blerë në v. 2016, sipas kontratës së shitblerjes është në vlerën 125.000 euro dhe është deklaruar në vlerën 140.000 euro. Nuk është e qartë se çfarë është patur parasysh me vlerën e deklaruar prej 140.000 euro.
- Rezulton se vlera e automjetit tip Land Rover me targa (***) , të jetë në shumën 45.000 euro, nga e cila 36.000 euro, financuar nga Credins Leasing, kredi e mbyllur në v. 2013. Ky automjet është deklaruar në vlerën 11.000 euro. Rrjedhimisht, mosdeklarim i vlerës reale të automjetit me targa (***) , të blerë në v.2008.
- Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor, lidhur me burimin financiar që ka shërbyer për kryerjen e parapagimit në vlerën 9.000 euro dhe shlyerjen e kredisë në vlerën 36.000 euro për periudhën 2008-2013, pasi nuk janë deklaruar të ardhurat e përfituara për këtë periudhë kohore.
- Mungesë dokumentacioni justifikues për të ardhurat nga pensioni i S.H (nëna) dhe paqartësi lidhur me shumën e deklaruar të të ardhurave nga pensioni prej 10.000.000 lekë.
- Transaksionet financiare të konfirmuara nga ISP Bank dhe Alpha Bank i përkasin periudhës 2000 - 2019. Nuk është e qartë burimi financiar i këtyre transaksioneve si dhe lidhja e kandidatit me shtetasit të cilit kanë kryer kreditimet, për faktin se nuk janë deklaruar të ardhurat financiare të përfituara për këtë periudhë.

- Nuk është përmbushur plotësisht detyrimi ligjor për deklarimin e të ardhurave, kjo e përcaktuar në faqen nr. 4, të formularit të deklaratës së pasurisë “Angazhime dhe veprimtari private dhe/ose publike dhe të ardhurat e krijuara prej tyre”.
- Mungesë dokumentacioni ligjor në lidhje me huanë e dhënë nga shtetasja V.D.
- Është e paqartë marrëdhënia juridike me adresën Rr. “D.K”, Pall (***) , Tiranë, pasi nuk ka deklaruar pasuri të paluajtshme në pronësi, posedim apo me qira, në këtë adresë.
- Për transaksionet financiare të konfirmuara nga Credins Bank, konkretisht kredi në vlerat 14.300 euro në v.2003 dhe 50.000 euro në v.2007 për blerje apartamenti, nuk është i qartë burimi financiar i shlyerjes së këtyre kredive, pasi nuk janë deklaruar të ardhurat financiare të përfituara për këtë periudhë.
- Rezulton se Altin Hazizaj, nuk ka deklaruar të qenit si garantor në kredinë, në vlerën 17000 euro në datë 22.11.2016, dhe gjendje detyrimi në datë 02.05.2019 në vlerën 14.061 euro në ABI Bank, të marrë nga shtetasit M. dhe A.P.
- Dyshime në lidhje me vlerën e blerjes 2.000.000 lekë të apartamentit me sip. 50 m2, në Durrës, pasi në v. 2007 është marrë kredi 50.000 euro për blerjen e këtij apartamenti, dhe në v. 2016 është shitur 67.000 euro.
- Për transaksionet financiare të konfirmuara nga DPPP, konkretisht në Alpha Bank në v. 2011 dhe ISP Bank në v. 2016, nuk është i qartë burimi financiar pasi kandidati nuk ka deklaruar të ardhurat e përfituara për këtë periudhë.

47. Në zbatim të pikës 26 të Vendimit nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “, nisur nga gjetjet e sipërcituara në rezultatet e kontrollit të ushtruar dhe përfundimet e raportit të ILDKPKI, në datën 29.05.2019, Këshilli ka njoftuar në rrugë elektronike kandidatin Altin Hazizaj mbi të drejtën e tij për të dhënë shpjegimet përkatëse mbi këto gjetje, si edhe të depozitojë çdo dokument justifikues të nevojshëm sipas vlerësimit të tij.

48. Kandidati Altin Hazizaj, në datën 31.05.2019, ka depozituar pranë Këshillit shpjegimet e tij me shkrim lidhur me gjetjet e njoftuara të procedurës së verifikimit për sa i përket kontrollit të pasurisë, nëpërmjet të cilave, në thelb, parashtron se :

- *Gjetja 1: Apartamenti me sip. 55m2 ne adresën “Rr. Q.S.” sipas dokumentit të privatizimit rezulton me vlerën 4.263 lekë. Ndërkohë që nga ana ime, është deklaruar si vlerë e po këtij apartamenti shumë prej 50,000 Euro. Në këtë aspekt, ILDKPKI rezulton të ketë bërë një gjetje që nuk është në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 33/2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, si dhe akteve shoqëruese të këtij ligji të miratuara nga Këshillit të Ministrave (VKM 132, datë 07.03.2018 dhe VKM Nr. 168, datë 27.03.2019), të cilat kanë përcaktuar vlerën e pronave në zona të ndryshme kadastrale në Tiranë dhe vlerën në shitje të tyre. Në këtë kuadër për të përlllogaritur vlerën reale të pronës janë përdorur çmimet e referencës së përcaktuara nga Këshilli i Ministrave të RSH.;*
- *Gjetja 2: “Rezulton se apartamenti me sip. 92.5 m2, në Tiranë i blerë në vitin 2016” është e vërtetë që deklarimi i bërë nga ana ime është në vlerën 140,000 Euro ndërkohë që vlera e shitjes ka qenë 125,000 Euro. Ky është një lapsus njerëzor nga ana ime, për shkak se vlera origjinale e pronës së kërkuar nga pronarja e hyrjes ka qenë fillimisht 140,000, e cila më pas është ulur në 125,000. Kjo pasqyrohet tepër qartë edhe në komunikimin që Banka ABI ka patur me ILDKPKI ku vlera fillestare e kredisë së kërkuar ka qenë 140,000 Euro. Në këtë kuadër, pavarësisht gjetjes së ILDKPKI, më duhet të them se ata e kanë patur të gjithë informacionin në dosje për të kuptuar këtë lapsus;*
- *Gjetje 3: “Rezulton se vlera e automjetit Landrover... të jetë në shumën 45,000 Euro....”. Më duhet të deklaroj se kjo gjetje e ILDKPKI është e gabuar, pasi nuk është*

në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 156/2014, datë 27.11.2014 (Fletore Zyrtare Nr. 195, datë 24.12.2014) për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë, ku vlera e një malli të blerë i nënshtrohet amortizimit, i cili për mjetet motorike (automjete) është ligjërishit e përllogaritur në masën -20% në vit. Në këtë aspekt, vlera e automjetit Landrover, në pronësinë time si Avokat, e blerë në vitin 2008, në fund të vitit 2013, vlera e automjetit ishte 0 lek. Sidoqoftë, duke patur parasysh që në tregun privat një automjet mund të shitet në çdo kohë, pa patur parasysh vlerën e vërtetë të amortizimit, kam pyetur pranë konçensionarit ku është blerë mjete, dhe më ka komunikuar që vlera e përafërt e makinës mund të jetë rreth 10-11,000 Euro. Kjo është bërë për të eliminuar deklarinin me vlefën 0 lek, e cila në opinionin tim do të ishte e gabuar. Për sa më sipër, gjetja e ILDKPKI është e gabuar dhe nuk bazohet në ligjet e vendit.

- Gjetje 4: "Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me burimin e financimit...." Më duhet të them se gjetja Nr. 4 nga ana e ILDKP është tërësisht në mënyrë të gabuar dhe mbi të gjitha është kryer në kushtet e tejkalimit të kompetencave që i jep ligji këtij institucioni. Ligji Nr. 9049, datë 10.04.2003, në nenin 4 të tij, flet për afatin dhe objektin e deklarinimit, është tepër i qartë, kur thotë: "Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të interesave private, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare...." Ashtu siç shihet tepër qartë në deklarinin tim përpara këtij institucioni, e cila është administruar edhe nga ana juaj, deklarimi im i të ardhurave, i pasurive dhe i konfliktit të interesave, ka përfshirë datën 1 Janar 2018 - 31.12.2018, pra është bërë në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit.
- Në këtë kuadër, detyrimi im ligjor, ka qenë dhe mbetet, vetëm deklarimi i të ardhurave përgjatë këtij viti (2018), dhe nëse gjendja e detyrimeve të mia i përgjigjet ose jo të ardhurave të krijuara. Edhe vetë ILDKPKI e ka bërë të qartë në deklarinimet e tyre përfundimtare se nga ana ime "nuk ka patur deklarim të rremë".
- Të gjitha të ardhurat, detyrimet dhe pasuritë e krijuara nga ana ime përpara datës 1 Janar 2018 nuk duhet të kishin qenë objekt i kontrollit të ILDKPKI, pasi kjo nuk është kërkesë e ligjit dhe për më tepër nuk është i lejuar nga ana e tij. Po ashtu ILDKPKI në asnjë moment nuk ka kërkuar informacion shtesë për të ardhurat e mia para datës 1 Janar 2018, për shkak sepse kjo do të ishte në kundërshtim me ligjin. Në momentin kur ILDKPKI nuk ka kërkuar informacion në lidhje me të ardhurat e mia para datës 1 Janar 2018, pasi kjo nuk është kërkesë e ligjit, mbi çfarë bazë ligjore arriti në konkluzionin që ka mungesë të dokumentacionit justifikues? Në bindjen time inspektimi nga ana e ILDKPI duhet t'i ishte përmbajtur qartazi kërkesave të ligjit dhe duhet të ishte kryer vetëm për evidentimin e të ardhurave dhe detyrimeve të mia përgjatë vitit 2018; evidentimin e pasurive dhe të faktit nëse gjendja ime financiare justifikon pasjen e këtyre detyrimeve apo jo. Neni 4, paragrafi 1, jo më kot ka përcaktuar një afat të deklarinimit një vjeçar të detyrimit për të deklaruar, citoj: "të interesave private, burimit të krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare..." si një mënyrë për të limituar të drejtën kur një institucion shtetëror me status kaq të gjerë në inspektimin e tij, vëzhgon qytetarët privatë dhe ndërveprimet e tyre private. Qëllimi i ligjit është që të ndalojë pasurimin pa të drejtë apo nëpërmjet korrupsionit të zyrtarëve publikë që punojnë në institucione shtetërore, ndërsa unë nuk jam një zyrtar publik. Në këtë drejtim, janë organe të tjera shtetërore, të cilat e kanë për detyrë të kryejnë verifikimet dhe ndjekjen e burimeve të dyshimta të të ardhurave apo pasurive, një e drejtë kjo që për qytetarët privatë (jo zyrtarët publikë) nuk i përket ILDKPKI, dhe sigurisht asnjë institucion i tillë nuk është shprehur kundër meje me ndonjë vendim.
- Neni 24, paragrafi i 2-të, i ligjit 9049, për deklarinin dhe kontrollin e pasurive..., thotë: "Kur nga përpunimi paraprak vërtetohen gabime materiale ose plotësime të gabuara, Inspektorati njofton subjektin që ka paraqitur këto deklarime, i cili, brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit, është i detyruar t'i ndreqë ato." Që nga dita e dorëzimit

tim pranë ILDKPKI të formularit dhe të gjithë dokumentacionit të kërkuar prej tyre, mua nuk më është kërkuar në asnjë moment që të paraqes dokumenta shtesë apo të bëj korrigjime të gabimeve që mund të ishin vërejtur nga përpunimi paraprak i të dhënave. Në këtë drejtim, ndodhemi në kushtet kur ILDKPKI nuk ka ushtruar të drejtën që i jepte ligji për të patur një plotësim të duhur apo edhe më të plotë të këtij deklarimi dhe që në mënyrë të njëanshme ka hequr dorë nga ushtrimi i kësaj të drejte.

- Gjetje 5: Mungesë dokumentacioni justifikues për të ardhurat nga pensioni..., në lidhje me këtë gjetje ju lutem gjeni bashkangjitur dokumentacionin e fotokojuar, që vërteton tërheqjen e pensionit të nënës sime S.H., pranë Zyrës Postare (***) , Tiranë. Në total shuma e tërhequr dhe e mbajtur nga unë për përdorim personal është 985,267 lekë, shumë të cilën në përlllogaritjet e mia rezultonte gabimisht që të ishte 1,000,000 lekë.
- Gjetje 6: “Transaksionet financiare të konfirmuara nga ISP dhe Alpha Bank...” është përsëri një gjetje jo e duhur nga ana e ILDKPKI për shkak sepse: Të gjitha të ardhurat që kanë hyrë në llogaritë e mia personale pranë bankës ISP (Intesa) përgjatë gjithë vitit 2018, janë të gjitha të ardhura që janë deklaruar në mënyrë tepër të saktë nga ana ime dhe që janë mëse të vërtetueshme nga dokumentacioni shoqërues, i cili gjendet në dosjen e ILDKPKI. Po ashtu janë vendosur në dispozicion kontratat qoftë ato të konsulencës qoftë edhe vërtetimi i të ardhurave nga punësimi.
- Në lidhje me Bankën Alpha, unë nuk kam patur asnjë të ardhur në këtë bankë as nga punësimi e as nga konsulencat, përgjatë të gjithë vitit 2018, kur ka qenë detyrimi im për të bërë deklaratimet sipas ligjit 9049. Në këtë kuadër, çdo vëzhgim i të ardhurave të mia para kësaj periudhe, nuk ka qenë objekt deklarimi përpara ILKDPKI dhe as subjekt i inspektimit të tyre. Në bindjen time inspektimi i tyre i kryer përpara datës 1 Janar 2018, në çdo bankë, është kryer në kundërshtim me ligjin 9049, për shkak se unë nuk kam qenë zyrtar publik në atë kohë apo subjekt i ligjit, sipas përcaktimeve të Nenit 4.
- Sidoqoftë përpara jush si relatore deklaroj me përgjegjësi të plotë, dhe siç vërtetohet edhe nga vetë inspektimi që ILDKPKI ka realizuar për figurën time, se nuk kam përfutur asnjëherë asnjë të ardhur nga burime të dyshimta apo të paligjshme. Të gjitha të ardhurat e mia që nga viti 1993 e deri më sot janë të ardhura të krijuara vetëm fal punës sime si gazetar, jurist dhe në vitet e mëvonshme si avokat apo konsulent privat.
- Gjetje 7: “Nuk është përmbushur plotësisht detyrimi ligjor për deklarimin e të ardhurave”, përsëri për këtë gjetje jemi në kushtet e kapërcimit të tagrit ligjor dhe të objektit të inspektimit nga ana e ILDKPKI, për shkak sepse ata i referohen të ardhurave të krijuara gjatë vitit 2017, dhe jo atyre që kërkohet të deklarohen për subjektin kërkues (Altin Hazizaj), gjatë vitit kalendarik 2018.
- Gjetje 8: Mungesë dokumentacioni ligjor..., bashkangjitur do të gjendjet dokumenti që vërteton huamarrjen.
- Gjetje 9: “Është e paqartë marrëdhënia juridike me adresën”, në lidhje me këtë gjetje, në kohën e dorëzimit të deklarimit, për shkak të rregullimeve në shtëpinë time, në adresën “Rr. Q.S., P. (***) , ...” kam jetuar për rreth 2 muaj në një shtëpi me qera. Për të qenë në rregull, kam shënuar në të adresën e banimit në kohën dhe ditën kur bëhej deklarimi përpara ILDKPKI.
- Gjetje 10: “Për transaksionet financiare të konfirmuara nga Credins Bank...”, përsëri për këtë gjetje jemi në kushtet e kapërcimit të tagrit ligjor dhe të objektit të inspektimit nga ana e ILDKPKI, për shkak sepse ata i referohen të ardhurave të krijuara gjatë vitit 2007, dhe jo atyre që kërkohet të deklarohen për subjektin kërkues (Altin Hazizaj), gjatë vitit kalendarik 2018.
- Në bindjen time inspektimi i tyre i kryer përpara datës 1 Janar 2018, në çdo bankë, është kryer në kundërshtim me ligjin 9049, për shkak se unë nuk kam qenë zyrtar publik në atë kohë apo subjekt i ligjit, sipas përcaktimeve të Nenit 4. ILDKPKI pavarësisht se është në dijeni që inspektimi i tyre, në rastin tim, nuk mund të shtrihej përpara datës 1 Janar 2018, përsëri në mënyrë të pashpjegueshme kanë dalë në konkluzione të gabuara gjatë inspektimit të tyre.

- Gjetje 11: “Rezulton se Altin Hazizaj nuk ka deklaruar të qenit garantor...”, është përsëri një gjetje tepër e gabuar nga ana e ILDKPKI. E para, ILDKPKI ka marr nga banka ABI (më parë Banka NBG) të gjithë dokumentacionin e kredisë në vlerën 17,000 Euro, të marrë pranë kësaj banke nga dy individë privatë dhe që nuk kanë asnjë lidhje familjare me mua. Po ashtu ILDKPKI ka marrë në inspektim të gjithë dokumentacionin e nënshkruar përpara Noterit (kontratë shitje) dhe nëse do të kishte kryer inspektimin në mënyrën e duhur, duke shfletuar të gjithë dokumentacionin e vënë në dispozicion, do të kishte kuptuar qartazi që Kontrata e Shitjes ndërmjet meje dhe dy shtetasve privatë, ishte një kontratë shitjeje me kusht, e cila në momentin e plotësimit të kushtit (pagesa prej 17,000 Euro) e humbiste fuqinë garantuese të saj. Kjo vërtetohet nga dokumentacioni i mëposhtëm, i administruar nga ILDKPKI, si më poshtë: Kontrata e kredisë së dy personave privatë me Bankën ABI, fillon faqe 252 të dosjes së ILDKPKI, në nenin 4 të saj kur flet për garancitë dhe në të dyja anekset A dhe B, në asnjë moment nuk përmend nëse kontrata ka një garantor dhe nëse ajo do të kishte, Kodi Civil kërkon që garantori të nënshkruajë se bie dakord të dal garant në sigurimin e kredisë. Në kontratë kjo e dhënë mungon për shkak se kontrata nuk ka garantor;
- Në Aneksin A, fq. 262 të dosjes së ILDKPKI, pika 3 thuhet shumë qartë detyrimi që të dy kredi-marrësit privatë më kishin mua si individ në shumën prej 17,000 Euro, diferencë e krijuar për shkak të shitjes së shtëpisë sime, shumë që e mbulonte banka me kredi; Aneksi B, flet në mënyrë specifike për garancitë e ofruara nga kredi-marrësit përpara Bankës ABI dhe aty në asnjë moment nuk përmendet emri im si Garantor i kredisë së tyre prej 17,000 Eurosh, që në fakt ishte detyrimi i tyre për t'u paguar përkundrejt meje;
- Kontrata e Hipotekës së nënshkruar ndërmjet meje dhe dy kredi-marrësve për hipotekimin e pronës në fjalë, në pikën 5 dhe 6 të saj e bëjnë tepër të qartë faktin që lidhja e kontratës së shitjes së shtëpisë ishte me kusht dhe Kushti i vënë ishte detyrimi i mbetur prej 17,000 Euro.
- Deklarata Noteriale, fq 281 e dosjes së ILDKPKI, e lidhur ndërmjet meje dhe të dy blerësve (Nr *** / Nr. Kol. (***) e shpjegon edhe një herë që në datën 25.11.2016 është realizuar plotësimi i kushtit, pra pagesa e detyrimit prej 17,000 Euro, dhe se që në atë moment unë i nënshkruari Altin Hazizaj hiqja dorë nga çdo e drejtë apo detyrim në lidhje me këtë pronë.
- Gjetje 12: “Dyshime në lidhje me vlerën e blerjes 2,000,000 lekë të apartamentit në vitin 2007”, është e çuditshme dhe e pashpjegueshme për mua se pse ILDKPKI ka arritur në këtë konkluzion, kur kontrata e lidhur ndërmjet meje dhe bankës Credins është tepër e qartë, dhe për më tepër ka vlerën ligjore të kërkuar nga ligji dhe të rregjistruar pranë organit të noterisë.
- Vlera e blerjes së apartamentit ka qenë 2,000,000 dhe ky dokument është i depozituar pranë Bankës ku është marr kredia, ndërkohë që unë kam kërkuar një kredi prej 50,000 Euro nga Banka Credins për të bërë të mundur blerjen e saj dhe më pas rregullimin tërësor të saj e pajisjen me orenditë shtëpiake. Për shkak se në atë kohë banka nuk ofronte kredi konsumatore, u ra dakord në negociata me ta që e gjithë shuma të konsiderohej kredi për shtëpi.
- Çdo qytetar është i lirë të negociojë kushtet e kontratës dhe më pas të hyjë në liri të plotë në marrëveshje me bankën, nëse e gjykon të arsyeshme lidhjen e saj dhe nuk është nën kushtet e lajthitjes, presionit, kërcënimit etj. Fakti që pagesa e kësteve të kredisë së shtëpisë është bërë në mënyrë të rregullt nga ana ime tregon se unë kam dhënë të gjithë pëlqimin tim për hyrjen në këtë marrëdhënie kontraktuale me Bankën dhe anasjelltas. Në këtë aspekt nuk shikoj asnjë gjë të dyshimtë në lidhje me këtë marrëdhënie. Në mendimin tim, ILDKPKI ka dështuar të provojë se pse kjo marrëdhënie ligjore, e vërtetuar që nga momenti i lidhjes së kontratës, marrjes së kredisë, pagesës së kësteve mujore dhe deri në mbylljen e saj, qenka e dyshimtë.

- *Gjetje 13: "Për transaksionet financiare të konfirmuara nga DPPPP, konkretisht Alpha bankë", përsëri për këtë gjetje jemi në kushtet e kapërcimit të tagrit ligjor dhe të objektit të inspektimit nga ana e ILDKPKI, për shkak sepse ata i referohen dy transaksioneve të ndodhura gjatë vitit 2011 dhe një transaksioni në vitin 2016, dhe jo atyre që kërkohet të deklarohen ligjërisht për subjektin kërkues (Altin Hazizaj), gjatë vitit kalendarik 2018. Për më tepër DPPPP i ka patur të gjitha mjetet ligjore në dorë, që nëse ata do të dyshonin për pastrim të parave, qoftë gjatë vitit 2011 (dy transaksione) apo një transaksion gjatë vitit 2016, për të kryer kontrollin e tyre në lidhje me burimin e të ardhurave, origjinën e tyre apo bllokimin e fondeve dhe pagesave, nëse ato vinin nga burime të paligjshme. Siç edhe e vërteton deklarimi i DPPPP në asnjë moment unë apo organizatat për të cilat unë kam punuar, nuk kanë qenë në kushtet e hetimit apo bllokimit të të ardhurave. Në këtë kuadër është e paqartë për mua se cili ka qenë qëllimi dhe çfarë ka dashur të arrijë ILDKPKI në përmendjen e dokumentit të ardhur nga DPPPP si gjetje, kur në fakt nuk ekziston një gjetje e tillë!*

49. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi verifikoi përputhshmërinë e të dhënave të deklaruara nga kandidati Altin Hazizaj në *Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Privatë të Kandidatit për Pozicione të Ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë* që ka depozituar pranë ILDKPKI, mbi bazën e të cilave ky institucion ka realizuar analizën financiare dhe ka ardhur në përfundimet e tij, në raport me të dhënat që rezultojnë nga informacionet e dërguara pranë Këshillit nga institucionet publike dhe private të treguara në pikën 15 të këtij Vendimi, sikurse edhe me shpjegimet dhe dokumentacionin shtesë si më sipër të paraqitura nga kandidati Altin Hazizaj.

50. Pas shqyrtimit të të gjithë dokumentacionin bashkëlidhur raportit të ILDKPKI dhe të shpjegimeve dhe dokumenteve shtesë të paraqitura nga kandidati Altin Hazizaj, Këshilli të Emërimeve në Drejtësinë i rezultoi se ky kandidat pretendon që ILDKPKI ka tejkaluar kompetencat e tij ligjore të përcaktuara në nenin 3 dhe 4 të ligjit nr.9049 dt.10.04.2003 në pjesën që ka kontrolluar të ardhurat e tij dhe burimet e financimeve të pasurive përpara vitit 2018. Sipas kandidatit objekti i kompetencave të ILDKPKI ishte vetëm të ardhurat e fituara prej tij në vitin 2018, pasi ligji ka vetëm një afat 1 vjeçar për kontrollin e pasurisë dhe kandidati nuk është zyrtar publik, që të kontrollohej çdo vit. Kontrolli i viteve të tjera për të ardhurat e kandidatit ka qenë objekt i institucioneve të tjera që nuk kanë konstatuar ndonjë parregullsi në të ardhura pasi nuk kanë marrë ndonjë vendim kundër tij.

51. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson se kandidati nuk ka plotësuar saktë formularin e deklaramit për pjesën e të ardhurave të tij të fituara nga momenti i fillimit të punës dhe të burimeve të financimit për çdo pasuri të tij në momentin e krijimit të tyre. Kështu, në formularin e deklaramit, rubrika e deklaramit të të ardhurave nga angazhimet e çdo veprimtari, nuk ka asnjë kufizim kohor për periudhën 1 vjeçare sikurse pretendon kandidati Altin Hazizaj. Formulari i është dorëzuar kandidatit nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, i cili dukshëm ndryshon në përmbajtjen e tij nga formularët periodikë të deklaramit që kufizohen në periudhën një vjeçare. Në këto kushte kandidati duhet të deklaronte të gjitha të ardhurat që ai kishte siguruar nga puna ose nga angazhimet e çdo veprimtari që ka gjeneruar të ardhura nga momenti kur ai kishte filluar punë deri në momentin kur ka bërë deklaramin e pasurisë.

52. Kandidati Altin Hazizaj nuk është subjekt i deklaramit periodik të të ardhurave për çdo vit sipas nenit 3 të ligjit nr.9049/2003. Si i tillë deklarimi i tij i pasurisë nuk rregullohet sipas parashikimeve të nenit 4 të këtij ligji i cili zbatohet vetëm me subjektet, që deklarohen periodikisht pasurinë. Kandidati ka deklaruar pasurinë për shkak se kandidon në vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Në këto kushte deklarimi i tij i pasurisë dhe kontrolli i pasurisë së tij bëhet nga ILDKPKI në bazë të parashikimeve të posaçme të nenit

235 të ligjit nr.115/2016 dhe të nenit 3/1 të ligjit nr.9049 dt.10.04.2003, ku ndër të tjera parashikohet se:

“1. *Mbartin detyrimin për deklarimin e pasurisë dhe të interesave privatë:*

.....
b) kandidatët që shprehin interesin për Inspektor të Lartë të Drejtësisë, si dhe kandidatët jomagjistatë për pozicionin e inspektorit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, sipas parashikimeve të legjislacionit që rregullon qeverisjen e sistemit të drejtësisë;

2. Kandidatët për pozicionet e përmendura në pikën 1, të këtij neni, që janë subjekte që mbartin detyrimin për deklarimin e interesave privatë, sipas parashikimeve të nenit 3, të këtij ligji, i nënshtrohen kontrollit të plotë të pasurisë.....

3. Inspektorati i Lartë kryen kontrollin e plotë për verifikimin e vërtetësisë dhe të saktësisë së të dhënave që përmbahen në deklaratën e personave të përmendur në pikën 1, të këtij neni, brenda 2 muajve nga paraqitja e deklaratës, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj. Në përfundim të verifikimit, Inspektori i Përgjithshëm u dërgon menjëherë institucioneve përkatëse raportin e verifikimit.”

53. Sipas parashikimeve të nenit 3/1 të ligjit nr.9049/2003 të sipërcituar rezulton e qartë se subjekti, që kandidon për Inspektor i Lartë i Drejtësisë plotëson formularin e deklarimit të pasurisë me të gjitha pasuritë që ka gjendje në momentin e deklarimit, si edhe me të gjitha të ardhurat, që ai ka fituar ndër vite deri në momentin e deklarimit të pasurisë. Këtij kontrolli të plotë të pasurisë i nënshtrohen jo vetëm personat që nuk janë subjekt i nenit 3 të ligjit nr.9049/2003, por edhe ata që janë subjekt i kontrollit periodik të interesave private sipas këtij ligji.

54. Në mbështetje të dispozitave ligjore të analizuara më sipër, Këshilli vjen në përfundimin që kandidati Altin Hazizaj nuk ka deklaruar në mënyrë të saktë të ardhurat e tij të fituara nga angazhimet e veprimtaria e tij para vitit 2018, gjë që e bën të pasaktë deklaratimet e tij të të ardhurave sikurse me të drejtë ka konkluduar edhe ILDKPKI në raportin përfundimtar.

55. Gjithashtu, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson se mungesa e deklarimit të të ardhura ndër vite nga ana e kandidatit Altin Hazizaj nuk përbën një gabim të korrigjueshëm gjatë procesit të verifikimit të pasurisë sipas nenit 24 të ligjit nr.9049/2003, sikurse pretendon kandidati. Kjo dispozitë parashikon se: “*Kur nga përpunimi paraprak vërtetohen gabime materiale, mospërputhje midis deklaratës së dorëzuar personalisht në formë fizike dhe deklaratës së dorëzuar me mjete të komunikimit elektronik, ose plotësime të gabuara, Inspektorati njofton subjektin që ka paraqitur këto deklarime, i cili, brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit, është i detyruar t’i ndreqë ato.*

56. Niveli i plotësimeve të gabuara dhe të korrigjueshëm sipas nenit 24 të sipërcituar të ligjit nr. 9049/2003 ka të bëjë me ato gabime materiale, të cilat rezultojnë qartazi nga të dhënat e pasqyruara në formular. Këto gabime nuk përfshijnë deklaratimet e pasakta të të ardhurave, pasi mosdeklarimi i tyre sikurse kërkohet në formular përbën shkelje sipas nenit 1/dh të Udhëzimit nr.475 dt.11.05.2017 dhe të neneve 15 e 40 të ligjit nr.9049/2003. Në formularin e deklarimit është përcaktuar se duhet të deklarohen të gjitha të ardhurat e siguruar nga puna e veprimtari të tjera që kanë gjeneruar të ardhura pa e kufizuar në kohë periudhën e deklarimit të këtyre të ardhurave, pra nga momenti që ai ka filluar punën deri në momentin e dorëzimit të deklaratës. Nga ana tjetër ligji prezumohet i ditur për të gjithë dhe ai vendos detyrimin për kontrollin e plotë të pasurisë, gjë që nënkupton se edhe deklarimi i të ardhurave si pjesë e formularit të deklarimit duhet të jetë i plotë.

57. Po kështu, megjithëse kandidati Altin Hazizaj ka pretenduar se nga ILDKPKI nuk i është njoftuar të deklaronte të ardhurat e tij të plota, përsëri ai nuk ka dhënë ndonjë deklaram

plotësues ose sqarues për këto të ardhura pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi në momentin e dorëzimit të sqarimeve kundërshtuese ndaj raportit përfundimtar të kontrollit të tij të pasurive. Përkundrazi, kandidati ka vijuar me kundërshtimin e kontrollit të pasurisë së kryer nga ILDKPKI mbi të ardhurat e tij përpara vitit 2018, si jashtë kompetencës së këtij institucioni, gjë që bie në ndesh me qëllimin e kontrollit të pasurisë sipas nenit 3/1 të ligjit nr.9049/2003 dhe nenit 235 të ligjit nr.115/2016, sipas të cilave duhet të kontrollohen të gjithë interesat private ndër vite të kandidatit.

58. Së fundi, në nenin 25 të ligjit nr.9049/2003 parashikohet se: *“Kontrolli aritmetik dhe logjik kryhet për çdo deklaram për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruar dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurive nga burime të deklaruar.”* Në kuptim të kësaj dispozite subjekti deklarues ka detyrimin të deklarojë të gjitha burimet e tij financiare ndër vite, me qëllim që ILDKPKI të kontrollojë nëse ky deklaram është i saktë dhe burimet e financimit janë apo jo të mjaftueshëm për të mbuluar pasurinë e deklaruar nga subjekti në kohën kur ajo është krijuar.

59. Nga raporti i ILDKPKI rezulton se ka mungesë deklarimi dhe mungesë sqarimesh për mënyrat se si janë krijuar të ardhurat në llogarinë bankare të kandidatit në Intesa Sanpaolo Bank dhe Alfa Bank në periudhën para vitit 2018e më konkretisht: veprim transaksioni nga vetë kandidati në shumën 10.288 euro, kreditimi në vlerën prej 46.965 euro nga E.Gj. , S. B.: në llogarinë e pagës në Alpha Bank në datën 27.04.2011 derdhur shuma prej 500 000 lekë nga E. Gj., në datën 11.05.2011 derdhur vlera nga Y.C., në datën 17.06.2014 derdhur vlera prej 180 000 lekë nga E.Gj., në datën 28.12.2015 derdhur vlera 335000 lekë. Për këto transaksione e disa të tjera ILDKPKI ka konstatuar se nuk është i qartë burimi i financimit dhe lidhja e kandidatit me shtetasit, të cilët kanë kryer kreditimet, pasi nuk ka deklaruar të ardhura financiare të përfituara në këtë periudhë.

60. Për këtë konstatim kandidati Altin Hazizaj në kundërshtimet e tij ka pretenduar vetëm se ILDKPKI ka tejkalluar periudhën e kontrollit që shtrihet sipas tij vetëm në vitin 2018. Megjithëse ka pretenduar se të gjitha të ardhurat e fituara në vite duke filluar nga viti 1993 janë rezultat i punës së tij si gazetar e jurist ose avokat e konsulent privat, nuk ka paraqitur asnjë shpjegim konkret se çfarë marrëdhënie financiare ka pasur me personat që kanë realizuar transaksionet ndaj tij dhe as ka paraqitur ndonjë dokumentacion për burimin e këtyre financimeve.

61. ILDKPKI ka për detyrë të verifikojë gjithë saktësinë e burimeve të financimit të subjektit në kuadër të verifikimit të plotë të pasurisë së tij. Në këtë drejtim fakti se nuk është konstatuar ndonjë shkelje nga institucionet e tjera verifikuese të pastrimit të parave, nuk përjashton kompetencën e ILDKPKI për të verifikuar saktësinë e çdo të ardhure të fituar nga subjekti me qëllim për të arritur një konkluzion të drejtë nëse kandidati ka pasur apo jo të ardhura të fituara ligjërisht si burime për financimin e pasurive të blera prej tij.

62. Në rrethana të tilla, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi gjen të drejtë për këtë pjesë konstatimet e ILDKPIK përderisa nga kandidati nuk është paraqitur asnjë dokument justifikues për fitimin e këtyre të ardhurave.

63. Të njëjtin kundërshtim ka parashtruar kandidati Altin Hazizaj edhe për transaksionet financiare të konfirmuara nga Credins BANK për vlerën 14.300 euro kredi në vitin 2003 dhe 50.000 euro në vitin 2007 për blerje apartamenti, pasi sipas tij, ILDKPKI nuk ka pasur kompetencë të verifikojë të ardhurat përpara vitit 2018. Lidhur me këto kredi, ILDKPKI ka konstatuar se kandidati e ka marrë në vitin 2003 dhe e ka shlyer në vitin 2006. Po kështu, ky kandidat ka marrë kredi në vlerën prej 50.000 euro në vitin 2007 të shlyer me këste deri në vitin 2016. Sipas ILDKPKI nuk është i qartë burimi i financimit të këtyre kredive sepse nuk

janë deklaruar të ardhura për këtë periudhë. Në kundërshtimet e dorëzuara në KED për këto konkluzione të raportit përfundimtar, kandidati Altin Hazizaj nuk ka paraqitur ndonjë shpjegim për burimet financiare, që ka disponuar në shlyerjen e këtyre kredive për periudhën 2003-2006 dhe 2007 -2016 kur shtrihet pagesa e tyre. Gjithashtu, nuk ka deklaruar në KED të ardhurat e tij në këtë periudhë megjithëse nuk i kishte deklaruar ato dhe kjo është konstatuar si gjetje nga ILDKPKI.

64. Në rrethana të tilla, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi gjen të drejtë për këtë pjesë konstatimet e ILDKPIK përderisa nga kandidati nuk është paraqitur asnjë dokument justifikues për fitimin e të ardhurave që kanë shërbyer për shlyerjen e këtyre kredive.

65. Për vlerën e të ardhurave nga pensioni i nënës së tij S. Hazizaj prej 10 000 000 dhe vlerës së huasë prej 1 300 000 lekë të deklaruar në formular, kandidati Altin Hazizaj ka sqaruar në kthimin e përgjigjes në KED se shuma e tërhequr prej tij dhe e mbajtur për interesa personale është 985.267 lekë duke iu referuar tërheqjeve të llogarisë, që ai kishte bërë për këtë shtetase. Pjesa më e madhe e këtyre tërheqjeve është bërë me mandat pagesën në vitin 2017. Në fakt ka një kontradiktë midis shumës së deklaruar hua prej 1 300 000 lekë dhe të ardhurave nga pensioni, ku deklarohet 10 000 000 lekë në formular. Vlera prej 10 000 000 lekë mund të jetë një gabim material, pasi në shpjegime kandidati referon shumën 1 000 000 lekë. Në shpjegimet bashkangjitur lidhur me huanë nga nëna kandidati ka dorëzuar tërheqjet nga llogaritë e saj dhe jo ndonjë kontratë të mirëfilltë huaje ose ndonjë deklaratë noteriale nga kjo shtetase për këtë hua. Nuk është sqaruar nga kandidati se ku konsiston diferenca midis shumës së deklaruar si e ardhur nga nëna dhe asaj të marrë hua. Subjekti nuk ka deklaruar të ardhura të mirëfillte nga nëna si person i lidhur, por të krijohet përshtypja se të ardhurat e deklaruar prej tij nga nëna janë pikërisht ato që ai ka përfutur prej saj në formën e huasë. Nëse do të ndiqej kjo logjikë atëherë ai duhet të kishte pasqyruar të gjithë shumën e huasë si të ardhur dhe jo vetëm vlerën prej 1 000 000 lekë. Mënyra e plotësimit të të ardhurave nga pensioni i nënës dhe i huasë prej saj krijon konfonde nëse kemi të bëjmë me dy burime të ndryshme financimi apo me një të vetme të paraqitur në deklaratë në dy rubrika. Megjithatë KED konstaton se me dokumentin shtesë të paraqitur kandidati ka konfirmuar të ardhurat nga pensioni i nënës së tij në vlerën prej 985267 lekë.

66. Nga gjetjet e ILDKPKI konstatohet se kandidati ka deklaruar vlera të ndryshme të pasurisë apartament prej 55 m² në rrugën Q.S. Tiranë në raport me atë të blerjes, vlerë të ndryshme për apartamentit prej 92.5 m² në raport me atë të blerjes, si edhe vlerë të ndryshme të automjetit Land Rover në raport me kohën e blerjes. Nga sqarimet e subjektit të paraqitura në KED kuptohet se ai ka deklaruar vlerën e pasurisë apartament 55 m² dhe automjetit Land Rover, duke iu referuar vlerës reale hipotetike, që këto pasuri mund të kenë në tregun e lirë në momentin e deklarimit sipas çmimeve të referencës të vendimeve të Këshillit të Ministrave për pasuritë e paluajtshme ose amortizimit sipas ligjit nr.156/2014 për automjetin.

67. Në lidhje me këto gjetje të ILDKPKI dhe shpjegime të kandidatit Altin Hazizaj KED konstaton se kandidati ka plotësuar në mënyrë të gabuar vlerën e këtyre pasurive në deklaratën e pasurisë. Në përputhje me ligjin nr.9049/2003 kandidati duhet të plotësonte në kolonën “vlera” çmimin e saktë të pasurisë në momentin e krijimit. Ai mund të referonte vlerën aktuale krahas asaj të momentit të krijimit vetëm në rast se do të kishte bërë një rivlerësim të pasurisë së paluajtshme rregullisht të regjistruar në zyrën e regjistrimit për pasurinë. gjë që në rastin konkret nuk rezulton të jetë kryer. ILDKPKI, në përputhje me nenin 25 të ligjit nr.9049/2003 verifikon burimin e ligjshëm të financimeve që ka pasuri subjekti në momentin kur e ka bërë pasurinë. Mbi këtë bazë shuma e vlerës që deklarohet është ajo e momentit kur pasuria është fituar nga subjekti. Pra edhe për këtë pjesë konstatimi i ILDKPKI gjendet i drejtë pasi subjekti nuk ka bërë një deklaram të saktë të vlerës së pasurive në momentin e krijimit.

68. Lidhur me pasurinë apartament prej 92,5 m², duket se në përcaktimin e vlerës prej 140.000 euro kandidati është konfunduar për shkak se krahas çmimit prej 125.000 euro për këtë apartament ka paguar edhe një shumë prej 15.000 euro për shkak të blerjes së mobilie, me të cilat ai ka qenë i ardhur nga shitësit. Nga dokumentet bashkangjitur të paraqitur nga kandidati sqarohet se përse ka ardhur kjo pasaktësi në deklaram.

69. Lidhur me adresën e konstatuar në lagjen *D.K.* subjekti ka dhënë shpjegime bindëse se kemi të bëjmë me një pasuri në përdorim të marrë me qira për shkak të arredimit të pasurisë së tij. Përderisa nga informacionet e ardhurave nga institucionet e tjera nuk rezulton që ai të ketë pasuri të paluajtshme të tjera veç atyre të deklaruara, ky shpjegim konsiderohet i pranueshëm.

70. Lidhur me huanë nga shtetasja *V.D.* kandidati ka paraqitur një konfirmë tërheqje prej saj në vlerën prej 1875 euro. Nga aktet e administruara në dosjen e ILDKPKI rezulton se shuma e marrë hua prej saj në fakt përbënte çmimin ende të papaguar nga kandidati për blerjen e mobilie me të cilën ajo kishte ardhur apartamentin. Palët kanë shndërruar marrëdhënien e mospërbushjes së detyrimit të pagimit të plotë të çmimit të apartamentit në kontratë huaje me qëllim që blerësi të paguante gradualisht në kohë çmimin e këtyre mobilie. Në këtë drejtim kandidati ka paraqitur dokumentacion që mbështet pretendimet e tij për huanë e marrë por nuk rezulton periudha kur ai e ka shlyer pjesën më të madhe të këtij detyrimi, me qëllim që të bëhej rakordimi i saktë nga ILDKPKI për burimet e të ardhurave në raport me shpenzimeve të subjektit në periudhën përkatëse. Vetëm mbi bazën e këtyre koordinimeve mund të përcaktohej nëse ka diferenca pozitive ose negative midis të ardhurave e shpenzimeve të subjektit në çdo vit financiar.

71. Lidhur gjetjen e ILDKPKI për detyrimin për të deklaruar qenien garant “hipotekues” në kredinë e marrë nga dy persona fizik privat Puto, KED konstaton të qarta dhe të provuara shpjegimet e dhëna nga kandidati Altin Hazizaj në shkresën kthim përgjigje në KED. Nga kontrata e hipotekës rezulton se kandidati ka vendosur si hipotekë pasurinë e tij apartament me nr. (***) në Durrës në favor të shlyerjes së kredisë nga shtetasit P., të cilët rezultojnë të jenë blerësit e kësaj pasurie nga kandidati. Shuma prej 17 000 euro ka qenë diferenca e mbetur pa shlyer nga blerësit. Për të bërë të mundur shlyerjen e plotë të vlerës së çmimit, blerësit kanë marrë kredi nga Banka duke u vendosur si hipotekë nga shitësi pasuria që ata kishin për qëllim të blinin. Me pagesën e diferencës së mbetur prej 17 000 euro në favor të shitësit A.Hazizaj ky i fundit ka pranuar me deklaratë noteriale se është bërë shlyerja e plotë e çmimit. Për rrjedhojë pasuria ka kaluar në favor të blerësve dhe hipoteka ka vijuar të jetë mbi pasurinë e blerë prej tyre derisa ata të shlyenin detyrimin ndaj Bankës. Në këtë mënyre rezulton se detyrimi i kandidatit si hipotekues ka përfunduar në datën 25.11.2016, kohë kur ai nuk ishte më pronar i pasurisë së vendosur në hipotekë. Nga certifikata e pronësisë e lëshuar në muajin dhjetor 2016 në emër të blerësve për pasurinë nr. (***), provohet se kandidati nuk ishte më pronar i pasurisë dhe hipoteka rëndonte në pasurinë pronë e blerësve. Duke qenë se në kohën e deklaramit të pasurisë detyrimi i tij si hipotekues ishte shuar pasi ai nuk ishte më pronar i pasurisë së vendosur në hipotekë, KED vlerëson se kandidati me të drejtë nuk ka deklaruar se është hipotekues në kontratën e kredisë në favor të shtetasve P.

72. Nga ILDKPKI është konstatuar se apartamenti në Durrës me nr. (***) është blerë nga kandidati Altin Hazizaj në shumën prej 2 000 000 lekë me kontratën e datës 03.03.2007, ndërkohë që lidhur me blerjen e apartamentit ai ka aplikuar dhe është disbursuar kredia në datën 18.04.2007 në vlerën 50 000 euro duke u ngritur dyshime mbi vlerën reale të blerjes së këtij apartamenti. Kandidati e ka kundërshtuar këtë gjetje me pretendimin se vlera reale e blerjes ka qenë 2000 000 lekë, por kredia ishte marrë në vlerën prej 50 000 euro edhe për shkak të rregullimeve dhe pajisjeve me mobilje që i ishte bërë apartamentit. Por, kandidati

nuk ka paraqitur ndonjë provë bashkangjitur lidhur me mënyrën se si janë realizuar këto shpenzime për arredim dhe rregullim si p.sh fatura të blerjes së orendive, fatura nga shoqëritë ndërtuese që mund të kenë bërë rikonstruksionin ose meremetimin e apartamentit, etj. Nga ana tjetër edhe në kontratën e blerjes së apartamentit duhet të deklarohet çmimi real i blerjes me qëllim, që pala shitëse të paguajë detyrimet tatimore pranë zyrën së regjistrimit në përputhje me çmimin e shitjes së apartamentit. Megjithëse detyrimi për pagimin e tatimit nuk i përket blerësit por shitësit, palët duhet të pasqyrojnë realisht çmimet e shitjes së pasurive të paluajtshme për të shmangur çdo dyshim mbi shmangie të detyrimeve ligjore. Duke qenë se ka një diferencë të dukshme midis çmimit të blerjes së apartamentit dhe shumës së lëvruar kredi për blerjen e këtij apartamenti, kandidati duhet të provonte mënyrën se si i kishte shpenzuar vlerën e kredisë së marrë me qëllim për të shmangur çdo lloj dyshimi mbi çmimin e blerjes së apartamentit. Gjithashtu KED konstaton se shuma e çmimit prej 2 000 000 lekë për blerjen e apartamentit rezulton të jetë paguar para datës 03.03.2007 kur është lidhur kontrata e shitjes, ndërkohë që kredia është disbursuar në datën 18.04.2007. Për shkak të mungesës së deklarimeve të të ardhurave nuk provohet se si është paguar shuma prej 2 000 000 lekë si çmim para se të merrej kredia.

73. Në rrethana të tilla, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi çmon se nga dokumentacioni i paraqitur nga kandidati Altin Hazizaj nuk rrëzohen në mënyrë përfundimtare dyshimet mbi mënyrën e realizimit të pagesës së çmimit për apartamentin në Durrës dhe vlera e çmimit real të blerjes në raport me vlerën e kredisë së lëvruar për këtë blerje.

74. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, pasi analizoi pretendimet dhe aktet shkresore të paraqitura nga kandidat Altin Hazizaj, çmon se çmon se ILDKPKI ka bërë një hetim të thelluar të pasurisë së këtij kandidati dhe të burimeve të të ardhurave të tij në të gjitha institucionet shtetërore, bankat e subjektet e tjerë që gjenerojnë të dhëna për pasurinë e të ardhurat dhe ka konstatuar me të drejtë se kandidati Altin Hazizaj nuk ka bërë deklaram të saktë në përputhje me ligjin gjë e cila për pasojë ka çuar në kontestimet për mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasurinë dhe mosdeklarim të pasurisë.

75. Për këto arsye, në zbatim të nenit 235 të ligjit nr. 115/2016, Këshilli vjen në përfundimin se kandidati Altin Hazizaj nuk plotëson kushtin që të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij. Për rrjedhojë, në zbatim të nenit 235 të ligjit nr. 115/2016, ky kandidat gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit për sa i përket verifikimit të pasurisë.

76. Këshilli vlerëson të ritheksojë se kushtet e kandidimit për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, të parashikuara nga Kushtetuta dhe ligjet e nxjerra në pajtim me të, duhet të plotësohen secila dhe të gjitha së bashku në mënyrë që kandidati të pranohet për tu vlerësuar dhe renditur sipas meritave nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi dhe më tej për tu përzgjedhur Inspektor i Lartë i Drejtësisë nga Kuvendi. Në rast se kandidati nuk plotëson qoftë edhe njërin prej kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, kjo do të përbënte motiv ligjor të mjaftueshëm për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi për të disponuar ndalimin e kandidimit, pa qenë më e nevojshme të arsyetojë për plotësimin ose jo të kushteve të tjera ligjore.

77. Për këto arsye, duke ardhur në përfundimin se në lidhje me kandidatin Altin Hazizaj është i mjaftueshëm të vendoset ndalimi i kandidimit për motivin e mosplotësimin të kushtit ligjor të përcaktuar nga neni 235 i ligjit nr. 115/2016, Këshilli vlerëson se nuk është vendi për të vijuar me tej me analizë dhe arsyetim mbi plotësimin ose jo të kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit.

78. Nisur nga sa analizohet dhe arsyetohet më sipër, bazuar në gjetjet dhe të dhënat e konstatuara gjatë procedurës së verifikimit që rezultojnë nga aktet dhe dokumentacionin që

përmban dosja e kandidimit, në interpretim dhe zbatim të ligjit të zbatueshëm për kushtet dhe kriteret e kandidimit për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vjen në përfundimin se duhet të vendoset ndalimi i kandidimit të kandidatit Altin Hazizaj në vendin vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, të shpallur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në datën 01.03.2019.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 229 dhe pikës 4 të nenit 235 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si edhe të shkronjës “b” të pikës 50 dhe shkronjës “a” të pikës 77 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

VENDOSI:

1. Ndalimin e kandidimit të kandidatit Altin Hazizaj, në vendin vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, të shpallur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në datën 01.03.2019.
2. Në zbatim të nenit 238 të Ligjit nr. 115/2016, ky vendim i njoftohet kandidatit Altin Hazizaj.
3. Kandidati Altin Hazizaj ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, jo më vonë se 5 ditë nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
4. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

KRYETARI

ARDIAN DVORANI

